



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 15/2009
Më 05. 05. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Mufëra Şinik dhe Zef Morina.

Mungoi: deputeti Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Fatmir Limaj, ministër - MTPT, Justina Pula – Shiroka, ministre - MEM, Endrit Shala dhe Xhevdet Smakiqi - MTPT, Lorik Haxhiu – MEM, Besim Zeqiri dhe Sagita Muço – ICO, Lejla Selimi – OSBE, Blerina Uka – NDI, Ramadan Klisurica – KDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 28. 04. 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të ART-së për vitin 2008;
4. Monitorimi i zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët;
5. Raportimi i MEM-it – lidhur me Projektin për termocentralin "Kosova e Re";
6. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për shkak të pjesëmarrjes së ministrave në mbledhje, u miratua me ndryshimin e renditjes, si vijon: pika III, kaloi në pikën V, pika IV, në pikën III dhe pika V, në pikën IV.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 28. 04. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 28. 04. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Monitorimi i zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugë

Kryetarja – E bëri një përshkrim të shkurtër të rrjedhës së punës së grupit të punës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët. Ky takim ka për qëllim të mbledhë informata të drejtpërdrejta nga ministrinë. Të dhëna do të shërbejnë për hartimin e raportit, i cili pas miratimit në Komision do të procedohet edhe në Kuvend. Në vazhdim kërkoi nga ministri Limaj ta informojë Komisionin, sipas vlerësimit të tij, për shkallën e zbatimit të Ligjit, për kompletimin me akte nënligjore, për organizimin e autoriteteve zbatuese, për vakumet dhe për pengesat që i ka hasur Ministria gjatë zbatimit të Ligjit.

Fatmir Limaj - ministër i MTPT-së – Theksoi se MTPT-ja i ka kushtuar një rëndësi të veçantë Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, me ndryshime e plotësime të tij, si dhe ka nxjerrë deri më sot 9 (nëntë) udhëzime administrative, me të cilat zbatohet ky ligj. Më të rëndësishmet i përmendi: Udhëzimi administrativ për mbikëqyrjen, për pranimin teknik dhe për bashkërendimin e punëve të kryera në infrastrukturën rrugore; si dhe Udhëzimi administrativ për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe të procedurave të vënies së panove në rrugët rajonale dhe magjistrale. Duke e paraqitur gjendjen e rrugëve, theksoi se fatkeqësisht është trashëguar e njëjta gjendje edhe më 2008. Angazhimi dhe prioriteti i Ministrisë ishte që menjëherë të ndryshohej kjo gjendje, në mënyrë që të mos shkelet ligji ose të bëhen ndërhyrje në brezin rrugor, siç ka ndodhur në të kaluarën. Shtoi se është në plan të merren masa parandalimi, që të mos ndodhë si në të kaluarën dhe njëkohësisht të fillojë të zgjidhen çështjet. Ministri Limaj tha se politikat e MTPT-së, krahas vrullit për ndërtimin e të gjitha rrugëve të reja në territorin e Republikës së Kosovës, rëndësi të madhe i kushtohet mbrojtjes së brezit rrugor në bazë të ligjit në fuqi. Për këto është aktivizuar Inspektorati i MTPT-së, si mekanizëm ligjor për mbikëqyrjen e brezit rrugor. Janë iniciuar dhe janë realizuar 163 inspektime, procese; 15 raste janë dërguar me fletëparaqitje në gjykatën kompetente dhe janë shpërndarë qarkore për të gjitha komunat e Kosovës dhe për ndërmarrjet publike, që të mos lejohet ndërhyrje në brezin rrugor. Po ashtu theksoi se Ligji nr. 2003/11 për rrugët, zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së rrugëve, ndërsa mbikëqyret nga Departamenti i Infrastrukturës Rrugore dhe nga Inspektorati i MTPT-së. Rezultatet e para janë në rrugën Prishtinë – Shkup (te QMI-ja). Aty u arrit që prona publike e uzurpuar të kthehet përsëri në shërbim të publikut, në shërbim të qytetarëve dhe të administrohet nga MTPT-ja. Këto veprime tregojnë vendosmërinë dhe përkushtimin e MTPT-së, që Ligji të respektohet dhe të ruhet pasuria publike. Ndërkaq, ministri Limaj i përmendi edhe problemet, që janë në infrastrukturën rrugore dhe përpjekjet që po bëhen për t'u futur infrastruktura rrugore në libra kadastrorë, që për

mendimin e MTPT-së dhe të ekspertëve, përfundimisht do të frekuentonte çdo manipulim të mundshëm me të ashtuquajturat letra nga palët të cilat kanë qëllime uzurpimi të pronës publike. Z. Limaj shtoi se, në përgjithësi, mund të thuhet se Ligji nr. 2003/11 për rrugët, tani me plot kuptimin e fjalës, po zbatohet në tërë territorin e Kosovës, ndoshta jo në masën e dëshiruar, sepse MTPT-ja po merret me sanimin e pasojave që janë edhe të së kaluarës.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se ky takim është i papërgatitur. Më parë është dashur të përgatitej një raport nga grupi i punës dhe pastaj të ftohej ministri përkatës. Kështu debati do të ishte i arsyeshëm dhe me kuptim. Kërkoj që ky takim të shtyhet për një mbledhje tjetër, pasi të jetë ofruar raporti.

Berim Ramosaj – E përkrahu diskutimin e z. Rexhepi. Ishte i mendimit se është bërë gabim në procedurë. Ministri është dashur të ftohej, pasi Komisioni ta kishte para vetes materialin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Kryetarja – Tha se ftesa për ministrin është e arsyeshme, sepse vendimi është marrë këtu në Komision, në mbledhjen e fundit. Sqaroi se është rregull që më parë të dëgjohen palët dhe pastaj të hartohet raporti për seance plenare.

Haki Shatri – Vuri në dukje se në këtë mbledhje nuk ka atmosferë për diskutim, sepse është dashur më parë ta kishim materialin dhe të ftoheshin përfaqësues nga Ministria. Kur të diskutohej edhe ata do të duhej t'i jepnin sqarimet. Së paku do të duhej të diskutohej raporti në mbledhje, pastaj të dërgohej në seancë. Kështu është procedura.

Kaqusha Jashari – Ishte e mendimit që sot të diskutohet, sepse ministri është këtu. Vendimi për këtë çështje është marrë më parë. Disa vërejtje që i kemi hasur gjatë mbikëqyrjes, tanimë janë përfshirë në Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, dhe janë nxjerrë një sërë aktesh nënligjore. Kishte edhe më pyetje, mirëpo për shkak të atmosferës së krijuar, tha se do t'i shtrojë në takimin e radhës.

Zef Morina – Tha se disa deputetë e kanë keqkuptuar rolin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Mendonin se ishte privilegj e jo kontribut. Shtoi se me mbikëqyrje nënkuptojmë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit e jo vlerësimin e teknologjisë së shtrimit të rrugëve. Grupi i punës ka hasur në shumë probleme lidhur me mosmbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit. U cek se përveç komunës së Mitrovicës, komunat e tjera, që janë vizituar, nuk e dinin që ka ligj. Tha se sot nuk ka nevojë të shtyhet kjo mbledhje, sepse në rend të ditës nuk e kemi shqyrtimin e raportit, por ende jemi në vazhdim të mbledhjes së fakteve. Kështu më parë duhet të debatohet, të dëgjohen të gjitha palët, të merren rezultatet e mbikëqyrjes në terren dhe pastaj të hartohet raporti, i cili pas miratimit në Komision, dërgohet në seancë plenare për debat.

Sala Berisha – Shala – Tha se gjithçka është sipas agjendës. Është marrë vendim të ftohen ministrat në Komision e jo deputetet të shkojnë atje. Rregullorja parasheh që pasi të procedohet raporti në seancë, debati të zhvillohet në seancë plenare e jo në Komision.

Safete Hadërgjonaj – Shfaqti shqetësimin lidhur me hartimin e këtij raporti, sepse mbikëqyrja mund të zgjatë më së tepërmi dy muaj, kurse ky grup pune ka një vit e gjysmë që ia ka filluar punës. Tha se janë plotësuar kushtet të hartohet raporti dhe të procedohet në seancë plenare.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Grupi i punës ta hartojë raportin e punës dhe t'i paraqitet Komisionit për shqyrtim dhe miratim.

IV. Raportimi i MEM-it – lidhur me Projektin për termocentralin "Kosova e Re"

Justina Pula – Shiroka - ministre e MEM-it – E lëshoi mbledhjen, me arsyetimin se ftesa nuk ishte e qartë, dhe kjo pikë e rendit të ditës të trajtohet në ndonjë mbledhje tjetër të Komisionit.

Ethem Çeku – Theksoi se në ftesë kërkohej të debatohej për një informacion të gjerë rreth Pakos së projektit "Kosova e Re", saktësisht për këto tema: Raporti i projektit "Kosova e Re" në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, në aspektin e ligjit dhe rreth transaksioneve financiare të Projektit. Njëherësh kërkoi nga stafi Mbështetës i Komisionit, që kjo ftesë më këto tema edhe një here t'i adresohet MEM-it.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

I. Përkrahet propozimi i z Çeku për përsëritjen e ftesës për MEM-in, në të cilin do të diskutoheshin temat ngritura.

V. Shqyrtimi i Raportit të ART-së për vitin 2008

Berim Ramosaj – Tha se ka njoftime se ky material nuk është debatuar në Bord. Kërkoi që edhe një here të ftohet kryesuesi i Bordit, pa marrë parasysh ka apo nuk ka mandat.

Zef Morina – Shtoi se edhe pse Bordi nuk ka mandat, mund të marrë pjesë këtu, sepse ky raport është për vitin 2008, në kohën kur ky bord ka pasur mandat. Propozoi të shqyrtohet sot në Komision dhe të nxirret rekomandim për seancë plenare. Po ashtu propozoi të ftohet në mbledhje të Komisionit z. Anton Berisha, kryetar i Bordit.

Safete Hadërgjonaj – Tha se ART-ja asnjëherë nuk ka dërguar raport të mirëfilltë në Kuvend, mirëpo prapë se prapë e kemi shqyrtuar. Njëherësh ishte e mendimit të debatohet në këtë mbledhje. Duke diskutuar për çështjen e mandatit të Bordit, tha, edhe pse dihet që ai nuk ka mandat, Komisioni duhet ta ketë një shkresë zyrtare për skadimin e mandatit të Bordit.

Ethem Çeku – Theksoi se ekziston dhe përsëritet çdoherë i njëjti problem lidhur me bordet. Kjo ndodh pothuajse në secilin bord dhe Komisioni përballet me këtë sfidë jo të vogël. Në fund bëri thirrje që Komisioni të ketë kujdes të marrë vendime meritore, në mënyrë që kjo të mos përsëritet në të ardhmen.

Kryetarja – Tha se raporti i ART-së as për së afërmi nuk i plotëson kushtet e një raporti standard, sepse ka mangësi të mëdha sa i përket hartimit të tij dhe mungesë të materialeve të rëndësishme.

Haki Shatri – Theksoi se javën e kaluar është hequr nga rendi i ditës kjo pikë, për arsye se nuk kanë qenë të pranishëm anëtarët e Bordit. Tani kur po përsëritet e njëjta situatë propozoi të njoftohet Kryesia e Kuvendit, me anë të një shkrese, në mënyrë që të kemi qasje në Bord dhe njëherësh të njoftohet MTPT-ja.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

I. Të ftohet në takimin e radhës kryetari i Bordit, z. Anton Berisha që ta paraqesë raportin vjetor të ART-së për vitin 2008.

VI. Të ndryshme

Çështje vijuese

Kryetarja – I njoftoi deputetët se në mbledhjen e radhës do të shqyrtohet në parim Projektligji për standardizim.

Kërkoi nga Grupi punues ta përshpejtojë punën e përpilimit të planit të veprimit për Komision.

Po ashtu e njoftoi raportuesin e grupit të punës për Projektligjin për gazin natyror, z. Fatmir Rexhepi se në adresë të Komisionit kanë ardhur disa materiale për këtë çështje. Njëherësh kërkoi prej tij ta thërrasë në mbledhje javën e ardhshme grupin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani